



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

.Numri i lëndës: 2018:055018
Datë: 02.11.2018
Numri i dokumentit: 00161060

P.nr. 865/2017

NË EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore ne Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur sipas gjyqtarit të vetëm gjykues Naser Maliqi, me sekretaren juridike Fikrete Destani, ne çeshtjen penale te te pandehurit M.H., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzes se Prokurorise Themelore ne Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP. II.nr. 1243/2017 të dt. 25.08.2017, e pas mbajtjes e shqyrtimit fillestar dhe publik me dt.25.10.2018, shpalle:

AKTGJYKIM

I pandehuri M.H. nga babai N. dhe e ëma T., i lindur më dt. ..., në Zhenevë, në Gjilan, në rrugë ... nr. ..., me vendqëndrim në Zvicërr, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

ËSHTE FAJTOR

Sepse, më datën 15.07.2017, rreth orës 19:00 minuta, në rrugën “Lidhja e Prizrenit” saktësisht në oborrin e kompleksit banesor “ ... ” në Gjilan, i pandehuri deri sa drejtonte automjetin BMW me tab. Regj ..., nga pakujtesia ka shkel Ligjin për Rregullimin e Trafikut Rrugorë, nga neni 45 paragrafi 1, sipas së

cilit dispozitë ligjore, vozitësi duhet të ketë kujdes të posaçme gjatë hyrjes në trafik dhe ti jep përparësi çdo mjete tjetër apo pjesëmarrist tjerë në trafik dhe i njehti me rastin e lëvizjes nga parking i kompleksit banesor në drejtim të rrugës dytësore, përkatësisht tentimin e kyçjes në rrugë pa respektuar përparësi kalimi nga ana e majtë, me ç'rast me pjesën e përarpme godet automjetin VW "Golf" ngjyrë hiri, e tab. Regj ..., të cilin e drejtonte Gj.J., i cili lëvizte në rrugën me përparsi kalimi përkatësisht në drejtim të këtij kompleksi banesor dhe nga kjo goditje për pos dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson ky i dëmtuar i cili për shkak të lëndimeve të marrura detyrohet të kërkoj ndihmën mjekësore në Qendër Emergjente në Gjilan,

-me çka ka kryer veper penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK.

Andaj ne baze te nenit 4,41,42,43,46,49,50,51,52,53,54,73,74,75,76 dhe nenit 365, 450 te KPPK-se dhe 463 të KPPK-së

E G J Y K O N

Me denim me gjobë në shumën prej 400 (katërqind) Euro, i cili dënim nuk do të egzekutohet me kusht që në afat prej 1 (një) viti i pandehuri mos të kryej veper tjetër penale .

Obligohet i pandehuri qe ne emer te paushallit gjyqesor, kësaj gjykate ti paguaj Shumen prej 20 euro, ndersa shpenzimet e procedures do te paguhen sipas llogarise perfundimtare te ksaj gjykate.

Për realizimin e këkresës pasurore – juridike i dëmtuari Gj.J. udhëzohet në kontest civil.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore ne Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me dt. 25.08.2017 ka ngritur aktakuzen PP/II, nr.1243/2017, ndaj te akuzuarit M.H., per shkak te vepres penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, duke kërkuar që pas mbajatjes se shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, i pandehuri te shpallet fajtor dhe te denohet me denim meritor sipas ligjit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me datëm 24.10.2018, ka mbajtur seancën e shyrtimeve fillestar, ku është lexuar aktakuza e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës i pandehuri M.H. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar se e pranon fajësin për kryerjen e kësaj veprë penale.

Gjatë shyrtimeve fillestar dhe publik kryetari i trupit gjykues pas degjimit të të pandehurit dhe prokurorit të shtetit, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësis, nga se janë plotësuar kushtet ligjore dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje me provat që gjinden në shkresat e lëndës edhe atë: raportin mjekësor me nr. 15014 të dt. 15.07.2017 lëshuar nga QE në Gjilan, fotodokumentacionin nga vendi i ngjajres si dhe deklaratat e të pandehurve dhe dëmtuarit.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësis, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se e njëjta nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit, konform dispozitave 73 dhe 74, dhe 76 të KPRK-se, gjykata ka marr për bazë rrethanat që ndikojn në llojin dhe lartësin e dënimit. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues si rrethana lehtësuese për të pandehurin ka marrë pranimin e fajësisë, student, është relativisht i moshës së re, është penduar dhe ka kërkuar falje për kryerjen e kësaj veprë penale dhe i premtton gjykatë që në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, ndërsa gjykata nuk gjeti rrethana rënduese për të pandehurin.

Sipas gjyqtarit të vetëm gjykues, dënimi me gjobë e i kushtëzuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit si dhe gjendjen financiare të tij, andaj konform nenit 41 të KPRK-se gjykata vlerëson se me këtë dënim me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit i cili konsiston në parandalimin e kryesit që në të ardhmen të kryej vepra tjera penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Kryetarit i trupit gjykues ka detyruar të pandehurin që kësaj gjykate t'ia paguaj Shumen paushalle në vlerë prej 20 euro, ndërsa shpenzimet e procedurës sipas llogaris perfundimtare të kësaj gjykate, gjithashtu të dëmtuarin për realizimin e kërkësës pasurore – juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
Me dt. 24.10.2018

Sekretare juridike ,
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykues:
Naser Maliqi

KSHILLA JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi, palet e paknaqura munde te ushtrojne ankese ne afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes ne Gjykatën e Apelit te Kosoves ne Prishtine, nepermes kesaj gjykate.